



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 709/Prot.

Tiranë, më 26.4.2021

1

VENDIM

Nr. 21, datë 26.04.2021

“Mbi miratimin e hapjes së programit të përbashkët të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” në “Analizë dhe Administrim Fiskal” në Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Drejtësisë të UT-së, për vitin akademik 2021-2022”

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2/b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1/dh”; neni 75; Udhëzimin e MASR-së nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu IV, gërma “A”, i ndryshuar; Udhëzimin e MASR-së nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Kreu I, pika 2; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31/ f si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Drejtësisë, përkatësisht me shkresat nr.174/1 prot., datë 08.03.2021 dhe nr. 219/1 prot., datë 19.03.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 26.04. 2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programin e përbashkët të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” në “Analizë dhe Administrim Fiskal”, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Drejtësisë të UT-së, për vitin akademik 2021-2022, sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Të miratojë formën e diplomës për programin e përbashkët të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” në “Analizë dhe Administrim Fiskal”, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Drejtësisë të UT-së.
3. Dokumentacioni përkatës t’i përcillet për miratim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Pas miratimit të MASR-së, sipas pikës 3 të këtij vendimi, dokumentacioni përkatës të përcillet edhe në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha